

Shpallje me: 19.04.2021
Për realizim me: 04.05



Në bazë të nenit 113 paragrafit 1 dhe 3 të Ligjit mbi vetëqeverisjen lokale ("Fleta Zyrtare e MZ", nr. 02/18, 34/19 dhe 38/20), e në lidhje me nenin 5 të Vendimit mbi organizimin mbi mënyrën e punës së administratës lokale të Komunës së Tuzit ("Fleta Zyrtare e Malit të Zi – dispozitat komunale", nr. 043/20) dhe Vendimit mbi fillimin e procedurave për plotësimin e vendit të punës, numër 01-031/21-5177 prej më 12.04.2021, Sekretariati për vetëqeverisje lokale - Zyra për burimet njerëzore, shpall:

SHAPLLJE PUBLIKE

për nevojat e Sherbimit të kryetarit të Komunës së Tuzit

1. Nëpun/e për mirëmbajtjen e pastertisë -Kabineti i kryetarit

- Ekzekutues: 1, në kohë të pacaktuar;
- Niveli i I2 i arsimit shkollorë;
- pa eksperiencë pune.

Dokumentacioni i nevojshëm:

- formulari i paraqitjes për vendin e lire të punës (Formularin e paraqitjes për vendin e lirë të punës kandidatët mund ta nxjerrin në web faqen e Komunës së Tuzit www.tuzi.org.me ose drejtpërdrejt në arkivin e Komunës së Tuzit),
- Curriculum Vitae – CV,
- fotokopja e letërnjoftimit biometrik,
- diplomë ose vërtetim mbi përfundimin e nivelit dhe llojit të arsimit
- vërtetimin e gjyqit kompetent se kundër kandidatit /es nuk zhvillohet procedure penale sipas detyrës zyrtare.

Periudha e provës në punë është e obligueshme për zyrtarin shtetërorë i cili për herë të parë lidh marrëdhënie pune në kohëzgjatje të pacaktuar në organin shtetërorë. Periudha e provës zgjatë një vit.

Kandidatët mund tia dorëzojnë kopjen e dokumentacionit të lartpërmendur Zyrës për burimet njerëzore (Në tekstin e mëtejme, Zyrës), përderisa origjinalin janë të obliguar tia japin në shikim zyrtarit të autorizuar të Zyrës për realizimin e shpalljes.

Me organin shtetëror nuk mund të lidh vend pune personi i cili është përdorues i të drejtës në pension, në pajtim me ligjin.

Zyrtari shtetëror, gjegjësisht nëpunësi i cili e ka realizuar të drejtën në paketën për shkurtim nga puna nuk mund të lidhin vendin e punës në organin shtetëror ose personin juridik, në periudhën prej një viti nga dita e pagesës së paketës për shkurtim nga puna. Kufizimi nuk vlen për personin i cili e kthen shumën totale të paketës për shkurtimin e punës që ka pranuar.

Verifikimi i dijës, aftësisë, kompetencave dhe shkathtësive, varësisht prej kategorisë së vendit të punës do të bëhet në pajtim me nenin 115 të Ligjit mbi vetëqeverisjen lokale ("Fleta Zyrtare e MZ", numër 02/18, 34/19 dhe 38/20), si dhe në bazë të nenit 17 të Dekretit mbi kriteret dhe mënyrën më të afert të kryerjes së verifikimit të njohurive, aftësive, kompetencave dhe aftësive për punën në organet shtetërore ("Fletorja zyrtare e Malit të Zi", nr. 050/18).

Verifikimi i dijës të kandidatit i cili i plotëson kushtet e shpalljes publike për vendin e punës së nënpunsit bëhet përmes intervistës me gojë.

Mbi datën, vendin, dhe mënyrën e verifikimit, të kandidatëve nga lista, kandidatët të cilët i plotësojnë kushtet e shpalljes publike do të jenë të njoftuar përmes ueb faqes së Komunës së Tuzit, më së largu pesë ditë para ditës së verifikimit.

Dokumentacioni i kërkuar është i nevojshëm të dorëzohet në afat prej 15 ditëve nga dita e shpalljes së konkursit publik në zarf të mbyllur (në të cilin është e nevojshme të shkruhet: emri dhe mbiemri, adresa, kontakt telefoni, emri i organit dhe vendi i punës) në adresën:

Komuna e Tuzit
Sekretariati për vetëqeverisje lokale - Zyra për burime njerëzore
Me shënim: për Shpallje publike për nevoja të Sherbimit të Kryetarit të Komunës së Tuzit

Kontakt tel: +38220875167;

SEKRETARË,
Marina Ujkaj

